

V E N D I M
Nr.18, datë 17.5.1996

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Rustem Gjata,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Hilmi Dakli,	Anëtari
Manol Konomi,	Anëtari
Feti Gjilani,	Anëtari
Veli Budo,	Anëtari
Zija Vuci,	Anëtar i“““
Franc Jakova,	Anëtari
Alfred Karamuço,	Anëtari

me sekretare Drita Filto, në datën 16.5.1996 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.23 Akti, që i përket :

K Ë R K U E S : VEIZ RAHMI KARAGJOZI

PALË E INTERESUAR : KOMISIONI SHETETËROR PËR KONTROLLIN E FIGURES SE ZYRTAREVE DHE PERSONAVE TE TJERE, i përfaqësuar nga Z. Muhamet Omari.

O B J E K T I :

Detyrimin e Komisionit të Kontrollit të Figurës së Personave Zyrtarë për t'i dhënë vendim, në bazë të neneve 7, 8, 9 të Ligjit nr.8043, datë 30.11.1995 “Për kontrollin e figurës së zyrtarëve dhe personave të tjerë që lidhen me mbrojtjen e shtetit demokratik”.

GJYKATA KUSHTETUESE, pasi dëgjoi relacionin përkatës,

V Ë R E N :

Veiz Rahmi Karagjozi, në kërkesën e paraqitur pranë kësaj Gjykate pretendon se me qenë se do vendosë kandidaturën për deputet, si subjekt i pavarur në zgjedhjet e 26 majit 1996, është paraqitur brenda afatit ligjor në Komisionin Shtetëror të Kontrollit të figurës së zyrtarëve dhe personave të tjerë, me kërkesën për t'i dhënë vendimin përkatës. Sipas kërkesës, ai pasi i ka plotësuar dokumentet, është paraqitur në zyrat e këtij komisioni në datën 23.04.1996, por nuk ka mundur të dorëzojë kërkesën e tij dhe vetëm në datën 25.04.1996 është vënë në dijeni se kërkesa nuk pranohet për shkak se ka kaluar afati ligjor.

Nga provat e administruara, Gjykata arrin në konkluzion se Veiz Rahmi Karagjozi është paraqitur në komision jashtë afateve ligjore, për pasojë komisioni nuk ka qenë i detyruar t'i japë atij vendimin përkatës.

Është e vërtetë se neni 7 i Ligjit nr.8043, datë 30.11.1995 nuk përcakton afat

për paraqitjen e kërkesës në komision, por nga përmbajtja e tij dhe e nenit 12 të Ligjit nr.7556, datë 04.02.1992 “Për zgjedhjet e Kuvendit Popullor”, ndryshuar me Ligjin nr.8055, datë 01.02.1996, del se lidhur me kandidaturat për deputetë, komisioni vepron deri në datën kur përfundon paraqitja e tyre në komisionin e zonave, pra 30 ditë para zgjedhjeve. Për pasojë komisioni, si rregull nuk ka pasur detyrim ligjor të marrë vendime mbas datës 26.04.1996, me përjashtim të rasteve taksative të përcaktuara në nenin 18 të Ligjit “Për zgjedhjet”.

Nga ana tjetër, Komisioni Shtetëror i Verifikimit të Figurës së zyrtarëve, ka obligim ligjor që vendimin ta japë brenda 15 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës. Për pasojë, kërkesi, që të respektojë afatin ligjor duhet t'i drejtohet komisionit 15 ditë përpara dhe jo 3 ditë si në rastin konkret.

Gjatë shqyrtimit të çështjes kërkesi ka pretenduar gjithashtu se shkak për kalimin e afateve ka qenë rregulli i vendosur nga komisioni sipas të cilit kandidatët e pavarur veç kërkesës duhej të paraqisnin dhe listat me nënshkrime të 400 zgjedhësve që mbështesin kandidaturën, rregull që sipas ankuesit del jashtë kërkesave ligjore.

Lidhur me këtë pretendim Gjykata Kushtetuese konstaton se edhe pse një kërkesë e tillë nuk është parashikuar shprehimisht në ligj, ajo është e arsyeshme për rastet e personave që pretendojnë për kandidaturë të pavarur për deputet.

Nëse do të zbatoheshin afatet ligjore të përmendura më lart, përgatitja e paraqitja e listave me

nënshkrimet e zgjedhësve nuk do të sillnin vonesë, ashtu siç nuk u kanë sjellë mjaft personave të tjerë, tashmë të regjistruar si kandidatë të pavarur për deputetë.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 24 pika 9 të Ligjit nr.7561, datë 29.4.1992 “Për disa ndryshime e plotësime në Ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese” dhe të neneve 7,8,9 të Ligjit nr.8043, datë 30.11.1995 “Për kontrollin e figurës së zyrtarëve e personave të tjerë...”, me shumicë votash,

V E N D O S I:

Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

U shpall sot, më datë 17.5.1996